

# WEBZINE

**TERMINUS** fokus rreth marrëdhënieve  
Shtator/dhjetor 2005 transkufitare në Mesdhe

I regjistruar pranë Gjykatës së Barit më 13/11/2002 me numër 1594



**TECA DEL MEDITERRANEO**  
**BIBLIOTECA MULTIMEDIALE**  
**& CENTRO DI DOCUMENTAZIONE**  
Istituita dal Consiglio Regionale della Puglia

**Redaktim:**

**Rosalba Magistro - Luigi Antonio Colecchia - Francesca Schiavone**

**Perkthimi nen kujdesin e:**

**Dhurata Vreshtazi**

**Perpunimi dixhital:**

**Valter Messorè**

**Informacion:**

**email: [webzine@bcr.puglia.it](mailto:webzine@bcr.puglia.it)**

**tel: +390805402716 - fax: +390805402775**

**TREGUESI**

**Treguesi**

**Site në internet**

**Banka elektronike të dhënash**

**Revista**

**Monografi**

**Shtypi i përditshëm**



# SITE NË INTERNET

## **BALLKANI**

<http://www.balcanionline.it>

Është siti i referimit për të gjitha iniciativat e realizimit të Ligjit nr. 84 të datës 21 Mars 2001 *Dispozitat për pjesëmarrjen italiane në stabilizimin, në rindërtimin dhe në zhvillimin e Vendeve të zonës ballkanike*. Realizimi i tij bën pjesë e projekteve të para të aktivuara në kuadrin e Ligjit nr. 84, dhe sheh bashkëpunimin e **Informest** – Qendër e Shërbimeve dhe Dokumentimit për Kooperimin Ndërkombëtar, **ICE** - Instituti kombëtar për Tregëtinë e Jashtme, e **Unioncamere** – Bashkimi kombëtar i Dhomave të Tregëtisë. Projekti, që inkuadrohet midis aktiviteteve të promovimit dhe të asistencës së ndërmarrjeve të parashikuara nga Neni 5 pika e e Ligjit nr. 84/01, i përgjigjet dëshirës për të konverguar në një instrument unik operativ pasurinë informative të siguruara nga aktorët kryesorë kombëtar që veprojnë në zonën ballkanike.

## **MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME**

[http://www.esteri.it/ita/4\\_28\\_62.asp](http://www.esteri.it/ita/4_28_62.asp)

Ministria italiane e Punëve të Jashtme propozon një seri studimesh të hollësishme dhe informacione të shumta rreth marrëdhënieve bilaterale. Gjithashtu siti propozon edhe një seri link të nevojshëm.

## **OBSERVATORI BALLKANI**

<http://www.osservatoriobalcani.org>

Për një zhvillim njerëzor, demokratik e sostenibële në Europën Jug-Lindore, Observatori rreth Ballkanit kryen një monitorim kolektiv. Synon të favorizojë proceset e zhvillimit nga pikëpamja sociale, kulturore, ambientale dhe ekonomike.

## **INSTITUTI KOMBETAR I TREGËTISE SE JASHTME**

<http://www.ice.gov.it/balcani/>

**Instituti Kombëtar për Tregëtinë e Jashtme**, në marrëveshje me strukturat qeveritare, vendos burimet e veta në favor të objektivit të përbashkët të rindërtimit të Kosovës si dhe të zhvillimit të Zonës Ballkanike. në veçanti, ICE u ofron asistencë ndërmarrjeve nëpërmjet zyrave të lokalizuara në Ballkan. Përsa i përket programit të rindërtimit të Kosovës dhe të vendeve të tjera të goditura gjatë konfliktit të fundit, Instituti vendos në dispozicion të ndërmarrjeve ekspertët në bashkëpunim pranë zyrës së Brukselit dhe zyrës në Romë.

## **ANSA**

<http://www.ansa.it/balcani>

Siti zyrtar i Ansa, i axhornuar në kohë reale, paraqet lajme me referim situatën, politikën, ekonominë dhe praninë italiane në Ballkan. Edhe ky sit është i pasur me link të nevojshme.

## **TURIZMI PERGJEGJES NE BALLKAN**

<http://www.viaggiareibalcani.org>

Është i pari sit rreth turizmit përgjegjës në Europën Jug-Lindore i realizuar në Itali. Është prezantuar në datën 1 Maj në Padova, në kuadrin e Civitas, ekspozita e ekonomisë sociale. Propozon itinerare të **turizmit përgjegjës** në Europën Jug-Lindore, me skeda informative e harta për secilin vend. "Të udhëtosh në Ballkan" është një sit që evidenton vendet me cilësi, pasurinë historiko-arkeologjike, pasurinë natyrore-ambientale, traditat lokale. Një stimul drejt kuriozitetit dhe vlerësimit të territoreve, por edhe të njohjes së projekteve të prosimitetit dhe te bashkëpunimit të decentralizuar.

### **PROVIDER SHQIPERI**

<http://www.albaniaonline.net>

Sit i pasur dhe shumë interesant. Është provideri më i shpejtë dhe më i besueshëm i shërbimeve disponibël në internet që i referohen Shqipërisë. Propozon edhe një seri lajmesh politike e aktuale, të historisë lokale dhe një forumi takimi për lexuesit. Siti është në shqip.

### **AMBASADA ITALIANE NE TIRANE**

<http://www.ambitalia-tirana.com>

Ambasada Italiane në Tiranë. Strukturat e Ambasadave dhe Konsullatave, Instituti Italian i Kulturës, informacione rreth Italisë dhe Shqipërisë, link.

Vendos në dispozicion edhe një **numër emergjenze për bashkëatdhetarët**, mund të telefonohet gjatë 24orëve nga gjithë territori shqiptar dhe nga jashtë Shqipërisë.

### **GUIDA ICE PER SHQIPERINE**

<http://www.ice.gov.it/estero2/tirana>

Guidë ekonomiko-tregëtare e kombit, mundësi biznesi e manifestimi, zyra lokale e Institutit italian për Tregëtinë e Jashtme.

### **SHOQATA KULTURORE "ILIRIA"**

<http://www.comune.montevarchi.ar.it/index.asp?para=type%7Cutil~idSez%7C9~IDURPLIVELLO%7C290~IDSCHEDAURP%7C1552>

Shoqata kulturore shqiptare "ILIRIA", ne portalin zyrtar të Komunës së Montevarchi. Aktiviteti i Shoqatës i drejtohet si komunitetit shqiptar ashtu edhe kolektivitetit. Favorizon integrimin e shqiptarëve në shoqëri. Ofron:

- shërbime informacioni, konsulence e asistence emigrantëve shqiptarë në Itali;
- u kërkon autoriteteve rajonale e lokale të përfaqësohen nga bashkëatdhetarët pranë institucioneve të ndryshme;
- **bashkëpunon me Ambasadën Shqiptare në Romë për të lehtësuar procedurat e autentifikimit të certifikatave dhe të diplomave të marra në Shqipëri** dhe të përkthimit të dokumentave të ndryshme shqiptare;
- organizon koncerte dhe ekspozita të artizanatit shqiptar në bashkëpunim me Entet Lokale dhe me shoqata të tjera me synim njohjen e kulturës dhe të traditave te Shqipërisë;
- promovon iniciativa kulturore dhe kreative.

### **ALISEI ONG**

<http://www.alisei.org>

Alisei Ong është një **organizatë jo qeveritare** që vepron në fushën e bashkëpunimit për zhvillim në nivel ndërkombëtar, të ndihmës humanitare dhe të edukimit ndërkulturor, ndërsa në nivel kombëtar vepron në fushën e politikave sociale.

Në kuadrin e projektit “Komunikimi i Europës: midis Ballkanit dhe Mesdheut” Alisei, me kontributin e Komisionit European, në partenariat me Cidis Onlus, Eurosportello Veneto, Komunën e Romë-s e Komunën e Bologna-s si dhe me pjesëmarrjen e Kanalit Evropa të Tiscali, Agjensia e Stampa Area e WaluEurope, sensibilizon qytetarët italianë rreth avantazheve të hyrjes në Bashkimin European në Maj 2004 të dhjetë vendeve të reja të Europës Lindore.

## **INSTITUTI PAQE ZHVILLIM INOVACION**

<http://www.acli.it>

Ipsia (Instituti Paqe Zhvillim Inovacion Acli) është formuar në 1985 si shprehje e solidaritetit popullor dhe të pranisë së punëtorëve kristianë të Acli në ndërtimin e një kulture të paqeje, bazuar në bashkëpërgjegjësinë e popujve në promovimin e drejtësisë midis njerëzve dhe kombeve. Tipologjitë e ndërhyrjes deri më sot kanë prekur sektorët: shëndetsi, shërbime sociale, mbështetje e rimarrjes së aktiviteteve ekonomik, shkolla e trajnimi profesional, rindërtimi i banesave dhe infrastrukturave. Deri më sot, përsa i përket Ballkanit, Ipsia ka ndërhyrë në: Slloveni, Bosnje, Kroaci, Serbi, Kosovë, Shqipëri.

## **KONSORCIUMI ITALIAN I SOLIDARITETIT**

<http://www.icsitalia.org>

Me fillimin e luftës në ish-Jugosllavi, verifikohet në Itali një mobilizim i madh i grupeve dhe shoqatave të shoqërisë civile, si përgjigje ndaj krizës humanitare. ICS (Konsorcium Italian i Solidaritetit) formohet në 1993 për të strukturuar dhe formalizuar eksperiencat e shumta të koordinimit që grupet lokale dhe shoqatat kombëtare kishin nisur. Në këto vite ICS ruan rolin e tij të organizimit, dhe falë aksionit të tij që dhjetra realitete italiane (ente lokale, shoqata, shkolla e universitete, etj.) përbëjnë marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi me palën lokale në Ballkan. Marrëdhëniet e lindura nga emergjenca, shpesh të nisura thjesht për dhënien e ndihmave humanëve, që do të zhvillohen në vazhdim në ndërhyrje të bashkëpunimit të decentralizuar.

## **INSTITUTE FOR WAR & PEACE REPORTING**

<http://www.iwpr.net>

Sit i **Institute for War & Peace Reporting**. Në programin e quajtur **Regional Reporting & Sustainable Training**, IWPR impenjohet për një periudhë afatgjatë të zhvillojë proceset demokratike në Ballkan. Gjithashtu mobilizohet për zgjidhjen e të gjitha konflikteve në zonën ballkanike dhe ndihmon në integrimin e shpejtë european të Ballkanit me krijimin e një network lokal të instituteve të kërkimit (**Balkan Investigative Reporting Network** [<http://www.birn.eu.com>]) që drejtojnë sondazhet e promovojnë projekte të dialogut midis popujve, përveç bashkëpunimit aktiv me mediat lokale.

Siti është në anglisht.

## **SHTYP I PERDITSHËM OSLOBODENJIE**

<http://www.oslobodjenje.ba>

Sit zyrtar i shtypit të përditshëm bosnjak **Oslobodjenje**. I pasur si grafikisht ashtu edhe me lajme të çdo lloji në përgjithësi.

[kthehu tek treguesi](#)



# BANKA TË DHËNASH ELEKTRONIKE

## De Agostini Professionale

Bankë të dhënash juridike, e konsultueshme edhe *on line* në Internet (veç CD-Rom e DVD-Rom) vetëm nga zotëruesit e licencës, me një axhornim të vazhdueshëm dhe në kohë reale.

Kjo bankë të dhënash informon rreth :

**Il Diritto Comunitario e dell'Unione Europea (Të Drejtës Komunitare dhe të Bashkimit Europian)**, i klasifikuar në 25 sektorë të mëdhenj tematikë, të pajisur me komentim juridik;

**Le Leggi d'Italia (Ligjeve Italiane)** me komentim juridik, të organizuara sipas përmbledhjes, të të gjitha Magjistraturave Superiore dhe të Doktrinës së juristëve prestigjiozë;

**Le Leggi regionali (Ligjeve rajonale)**, të vendosura në një bankë të dhënash të vetme me përmbajtje normativën e 20 rajoneve italiane dhe të provincave autonome të Trento e Bolzano (në version dy gjuhësh);

**I 7 Codici d'Italia (Shtatë Përmbledhje Ligjesh Italiane)** në tekstin në fuqi dhe të kordinuar;

**L'Archivio storico (Arkivit historik)** i akteve kombëtare;

**Le Circolari e le Istruzioni ministeriali (Qarkoreve dhe Instruksioneve ministeriale)**, të nxjerra duke filluar nga viti 1996 nga rreth 35 organe kompetente midis Ministrive, Instituteve dhe Enteve. Çdo ligj është në raport reciprok me masat legjislativë në përmbajtjen e bankës së të dhënave "*Codici d'Italia*". Vepra përmban si qarkore të publikuara në Gazetën Zyrtare, ashtu edhe ato të papublikuara të vështira për t'u gjetur.

Banka e të dhënave De Agostini mund të konsultohet në Bibliotekë me ndihmën e punonjësve të bibliotekës.

### \*Euro-lex Gazeta Zyrtare e Komunitetit Europian

Bankë të dhënash e konsultueshme edhe *on-line*, objektivi i të cilës konsiston në konsultimin e përmbledhjeve dhe të dokumentave të gazetave zyrtare falë funksioneve të kërkimit dhe të navigimit në internet. Ofron një kuadër komplet të të drejtës së BE si dhe procedura deçizive midis Komisionit dhe institucioneve të tjera.

**KONSULTIMI:** programi ka një seksion për navigimin në internet (listë kronologjike, hierarkike, sekuenciale, repertori) dhe një seksion për funksionet e kërkimit (kërkim i thjeshtë, në bazë të datës, në bazë të numrit të Gazetës Zyrtare, në bazë të emrit të ekspertit dhe të fjalëve çelës).

**PERIUDHA:** çdo botim mujor përbëhet nga 2 CD-ROM, një për serinë L (Ligje) dhe një për serinë C (Konkurse); të dyja përfshijnë përmbledhjet integrale të serive L (Ligje) e C (Konkurse).

Kjo bankë të dhënash Eur-lex është e konsultueshme në Bibliotekë me ndihmën e operatorëve.

[kthehu tek treguesi](#)



# REVISTA



**\*Prospektivat e ardhshme të Bashkimit Evropian / AAVV,**  
në: \*Comuni d'Evropa n° 9/2005, fq. 5-6

Bëhet fjalë për një Deklaratë e aprovuar nga Bureau ekzekutiv i Ccre në Stoccarda në 4 Korrik 2005. Në brendësi të tij, anëtarët e Ccre theksojnë se shumë janë goditur nga “JO” e ratifikimit të Kushtetutës Evropiane, e shprehur në Francë dhe në Hollandë në dy referendumet. Bureau i Ccre i drejtohet Drejtuesve të Shteteve dhe të Qeverive të vendeve evropiane për t’i ftuar në një punë të përbashkët që të mund të bëjë Bashkimin Evropian më demokratike dhe më pranë kërkesave dhe nevojave të qytetarëve.

Është e nevojshme të kalohen interesat kombëtare derisa Bashkimi Evropian

të fitojë respektin e suksesin në botë dhe të përballojë sfidat.

Vendndodhja në Bibliotekë: DEM 2 A 4



**\*Normativa rreth imigracionit në Shtetet e ne Komunitetin Evropian /**  
Eliseo Aja – Laura Díez  
Në: \*Diritto Immigrazione e Cittadinanza, n° 1/2005, fq. 13-35

Fenomeni i trishtuar dhe kompleks i imigracionit është protagonist i kësaj përmbledhjeje të shkurtër, në një projekt të kërkimit të financuar nga Ministria e Shkencave dhe e Teknologjisë së Spanjës. Në bazë të të dhënave të autorit, dy kanë qënë flukset emigratore drejt Europës, të kryera ne periudha dhe në modalitete të ndryshme: e para ka ndodhur menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, kur vendet evropiane të shkatërruara nga konflikti (Gjermani, Francë, Belgjik, Angli, Hollandë...) kishin nevojë për punëtorë të huaj për t’u impenjuar në procesin e rindërtimit të territorit dhe të ekonomisë.

Ky imigracion i parë përfundon në gjysmën e parë të viteve shtatëdhjetë.

Fluksi i dytë është i lidhur me fundin e shekullit XX, në momentin kur shtetet evropiane periferike që në emigrimin e parë kishin ofruar “lëndën e parë” (Itali, Spanjë, Greqi, Portugali) bëhen shtete destinacioni.

Në origjinë të këtij elementi, theksojnë autorët, vepron fenomeni i njohur si *push-pull*, *shtyrja* për tu larguar nga vendi i origjinës për shkaqe pune dhe të përmirësimit të jetës, dhe *tërheqja* nga vendi destinacion që duket se mund të sadsifaksionojë keto nevoja.

Nga kendvështrimi normativ, janë të shumtë elementët e përbashkët në legjislacionet e Shteteve evropiane në fushën e imigracionit. Mbi të gjitha orientimi i përgjithshëm në kërkimin e dhënies së lejeve të qëndrimit për motive pune të huajve.

Më pas është kriteri i përbashkët i prioritetit të zgjedhjes së të papunëve kombëtarë, komunitarë e të huajë me leje qëndrimi përpara se të vazhdohet me punësimin e një të huaji nga një vend i tretë.

Të njëjtë rezultojnë edhe principet e përgjithshme në lidhje me dhënien dhe kohëzgjatjen e lejes së qëndrimit, me bashkimin familiar, me sanksionet për t’u aplikuar për të parregullit.

Sigurisht mungesa e një rregulli të njëjtë për të gjithë vendet evropiane, shtyn legjislatorin lokal në një liri të gjerë në vendimet në këtë fushë, liri kjo që rrezikon të përdoret në mënyrë instrumentale (për motive politike e ideologjike).

Shpresohet në zhvillimin e një politike *globale* evropiane në fushën e imigrimit, e cila lejon reduktimin në minimum të klandestinitetit të punëtorëve të huajë.

Vendndodhja në Bibliotekë: BR 5B 7



**\*E drejta e lejes së qëndrimit për fëmijët e të huajve të bërë maxhorenë / Paola Balbo**

Në: *Gli \*Stranieri*, n° 3/2005, fq. 207-210

Autorja vë re se aktualisht në Itali nuk egziston asnjë rregullore e plotë për çështjen e bashkimit familiar për fëmijët e të huajve të bërë maxhorenë kur familja e tyre jeton rregullisht në Itali. Kjo sepse ligji konsideron adoleshentin e bërë maxhoren si një cilido qytetar ekstrakomunitar që mbrin në Itali dhe që duhet të kërkojë lejen e qëndrimit sipas procedurave burokratike. Kjo nuk korrispondon me realitetin sepse subjekti i bërë maxhoren ka më shume mundësi për integrim sepse ka jetuar në këtë

territor në krahasim me kë vjen për herë të parë.

Shpresohet të arrihet jo vetëm në një njohje të lejes së qëndrimit për kë arrin moshën maxhorene kur gjendet në territorin italian, por edhe për kë bëhet maxhoren jashtë Italisë të ketë mundësinë për të kërkuar bashkim familje sipas rregullave në fuqi.

*Vendndodhja në Bibliotekë: BR 4E 1*



**\*Demografia, migrazioni e politiche migratorie nel bacino del Mediterraneo / Annalisa Busetta, Cristiano Marini**

Në: *\*Affari Sociali Internazionali*, n° 2/2005, fq. 15-22

Studimi i tendencave demografike në kombet e mesdheut tregon sesi në vitet 2005-2030, vetëm Anglia dhe Franca, midis vendeve të BE, nuk do të kenë një reduktim të popullsisë kolektive, ndërsa kjo do të verifikohet në Itali me (-10%). Kjo do të sjellë një reduktim edhe në popullsinë e aftë për punë. Veçanërisht do të mbeten të zbuluar punët e vështira, që jo vetëm qytetarët lokalë por edhe të huajt e gjeneratës së dytë, në kërkim të një promovimi social, nuk do të duan ti bëjnë.

Kështu në periudhën e treguar, një rol të rëndësishëm do të kryejë imigrimi i qytetarëve të rinj për t'u impenjuar si forcë-punë. Prandaj për të bërë që kjo të sjellë avantazhe në planin social-ekonomik është e rëndësishme që nga ana e territorit pritës të ketë kapacitetin për të garantuar integrimin e plotë të imigrantëve të rinj.

Në të kundërt që tani Qeveria Italiane konsideron të tepërt praninë e imigrantëve në territorin italian dhe vë në veprim politika të kontrollit të fenomenit si dhe largimin e pranive të tepërta.

Shpresohet që të dy fenomenet (reduktimi drastik i popullsisë dhe shtimi i qytetarëve të huajë në territorin italian) të gjejnë së shpejti një pikë takimi që lejon futjen pa trauma të punëtorëve të huajë në territorin italian.

*Vendndodhja në Bibliotekë: BR 5C 8*



**\*Rjetet e transporteve panevropiane në zonën mesdhetare / Katia Marcantonio**

Në: *\*Rivista di Studi Politici Internazionali*, n° 4/ 2005, fq. 659-674

Interesante ese rreth lindjes dhe rolit të rrjeteve të transportit panevropiane (korridore) dhe të vlerës së tyre në marrëdhëniet e bashkëpunimit social-ekonomik midis vendeve që përshkojnë.

Në Konferencën panevropiane të ministrave të transportit të Pragës (1991) përcaktohet lindja e koshencës për nevojën e rritjes së udhëtimeve të brendshme panevropiane. Janë organizuar edhe Konferenca të tjera (Kreta 1994; Helsinki 1997; Rotterdam 2001) ku janë përcaktuar rrugët prioritare

të quajtura nga të gjithë “korridore”.

Dhjetë korridoret aktuale të njohura nga Komisioni Evropian interesojnë më tepër zonën ballkanike sesa zonën mesdhetare, përjashtim bënë Turqia e përshkruar si nga Korridori VIII (ai që prek edhe Puglia-n në drejtimin Bari-Brindisi-Durrës-Tiranë-Shkup-Sofje-Burgas-Varna) ashtu edhe pjesërisht nga Korridori IV. BE interesohet për vendet mesdhetare të papërfshira në korridore, duke u bërë promovuese e një politike partneriteti e bazuar në interesat e përbashkët.

Nga pikëpamja legjislative nënvijëzohet rëndësia thelbësore e lindjes edhe të një hapësire juridike globale në funksionimin global të rrjeteve ndërkombëtare panevropiane.

*Vendndodhja në Bibliotekë: BR 4E 11*



**\*Imigratët e Lindjes në Itali dhe në BE** Franco Pittau – Antonio

Në: \*Affari Sociali Internazionali, n° 2/2005, fq. 23-38

Në Maj të 2004 BE ka celebruar zgjerimin e tij në Lindje me aderimin në kufijt e tij të Sllovenisë, Sllovakisë, Republikës Çeke, Hungarisë, Polonisë, Estonisë, Letonisë e Lituanisë.

Të shumta janë rrënjët e përbashkëta ndërmjet këtyre popujve, ku detaj i paevitueshëm është kristianizmi. Por të shumta janë edhe dallimet: etnike, gjuhësore, kulturore.


Në të kaluarën një numër i madh imigrantësh, edhe ilegalë, të ardhur nga këto vende të Evropës Lindore i ka lejuar vendeve perëndimore një zhvillim më i lulëzuar i sektorëve të ndryshëm të punës të cilët kishin nevojë të

zgjerimin potencialin e vet prodhues.

Është mirë të nënvijëzohet që vendet e Evropës Lindore nuk janë vetëm vende të imigrimit por edhe “tranzit” sepse shpeshherë qytetarët e larguar nga prej tyre, për pamundësi për të arritur drejtëpërdrejtë e legalisht në perëndim, janë të detyruar t’i afrohen lehtësisht destinacionit. Favorizimi i një inserimi praktik dhe legal të imigrantëve nga Evropa Lindore do të shërbente edhe në luftën kundër organizatave të shumta që drejtojnë trafikun e klandestinëve përveç shfrytëzimit të tyre kur mbrijnë në destinacion.

Paragrafët e fundit të kësaj eseje kanë përmbajtje të tipit statistikor dhe janë të pasuruara me tabela përmbledhëse.

*Vendndodhja në Bibliotekë: BR 5C 8*



**\*Distriktet kulturore në vendet e avancuara në ekonomi emergjente /**

Walter Santagata

Në: \*Economia della cultura, n° 2/2005, fq. 141-152

Teorikisht mund të deklarohet se një distrikt kulturor është frut i dy faktorëve: 1) prania e ekonomive të jashtme dhe të aglomeratit; 2) njohja e natyrës së prodhimit të kulturës.

Shumë tipe të distrikteve kulturore janë impostuar dhe janë të dukshëm në sytë e të gjithëve dhe i kanë dhënë jetë industrive ekonomike me rëndësi të madhe: ajo e kinemasë në Hollywood, të tekstilit në Prato, të xhamit artistik në Murano, etj...


Ajo çka duhet për të transformuar një distrikt potencial në një distrikt real, është presioni në sferat politike për njohejne dhe promovimin e tipologjive të produkteve (ekonomike e kulturore) lokale. Inspirimi i ri ndaj komuniteteve lokale po arrin edhe nga distriktet kulturore urbane, shumë të përhapura në Shtetet e Bashkuara dhe në Angli, e që konsistojnë në aglomerate spaciale të ndërtesave të përshtatura me artet figurative, muzeve, organizatave që prodhojnë kultura dhe të mira të bazuara në kulturë.

Një dëm i madh për kulturat auyoktone mund të provokohet nga proçesi i globalizimit. Kjo mund të shmanget duke zhvilluar kritere politike që mbrojnë kulturën lokale dhe aktivitetet ekonomike.  
*Vendndodhja në Bibliotekë: BR 6C 7*

[kthehu tek treguesi](#)



# MONOGRAFI



\***Debating National Security : selected issues : border security, religion and security, corruption** / [a cura di] Albanian Institute for International Studies. - Tirana : Albert Rakipi, c2004. - 90 p. : ill. ; 23 cm.

TREGUESI. \* *Border security and beyond* \* *National security and religion* \* *Corruption*

Teksti është pjesë integruese e një projekti të madh të quajtur “National Security Issues – Promoting civil society participation and expertise”. Gjithë kërkimi është zhvilluar nga AIIS (Albanian Institute for International Studies) me mbështetjen e rëndësishme të Komisionit Demokracia Programi Piccole Sovvenzioni, të Ambasadës USA në Shqipëri.

Qëllimi i dokumentit është analizimi i pikave fokale në lidhje me sigurimin kombëtar në territorin shqiptar. Shkrimi është i ndarë në tre pjesë me përmbajtje të tre argumentave: sigurimi në kufij e më tej, sigurimi kombëtar e fetar, korrupsioni.

Përsa i përket **sigurisë në kufijë**, qeveria shqiptare duhet të gjykojë, sygjerojnë autorët, rreth mënyrave të arritjes në bazat e dy problemeve të mëdha të emigrimit dhe të kontrabandës. Shumë i rëndësishëm mbetet roli i asistencën ndërkombëtare, edhe nga pikëpamja financiare, për të luftuar rastet e përmendura dhe që Shqipëria të mund të disponojë ato fonde të domosdoshme për të treguar që është një partner i mirë ndërkombëtar dhe që ka dëshirë politike për të luftuar krimin e organizuar.

Për sigurinë në kufijë me shumë rëndësi është edhe bashkëpunimi midis vendeve të ndryshme të Ballkanit perëndimor.

Në rastin e **sigurisë kombëtare** është e pamohueshme që besimi fetar ose besimet fetare kryejnë një rol shumë të rëndësishëm. Prandaj këshillonteksti, është e nevojshme të forcohet komuniteti myslyman shqiptar për të garantuar dallimin me çdo formë të radikalizimit potencial.

Janë thirrur edhe *mediat* për të adoptuar një kod etik, sidomos në momentin kur flitet për besim fetar. Nëse besimtarët e cilitdo besimi do të ndiheshin të fyer kjo s’do të ishte bjë gjë e mirë!

E rëndësishme është që edhe marrëdhëniet midis Shtetit dhe komunitetit besimtar të zhvillohen në kontekste institucionale.

Argumenti i fundit i trajtuar është fenomeni i **korruptionit**. Kjo plagë ka një impakt negativ në jetën ekonomike të vendit dhe i heq legjitimitetin qeverisë dhe sistemit politik. Korrupsioni është i përhapur, por qeveria shqiptare po mobilizohet, për shembull, me trajnimin profesional të *Unitetit Qeveritar Anti-Korrupsion e Komiteti i Monitorimit*. Sondazhet e fundit fatkeqësisht (një screening midis 1999 e 2002) kanë treguar që ky element nuk shfaq shenja reduktimi. Pritet një axhornim i të dhënave.

*Vendndodhja në Bibliotekë: BM 29H 33p*

\***Autopsia e Ballkanit : ese e psiko-politikës** / Rada Iveković. – Milano : Cortina, c1999. - 186 fq. ; 21 cm.

TREGUESI. \* *Qytetërimi dhe progresi* \* *Shkenca e besimi fetar* \* *Shoqëria dhe ekonomia* \* *Kombi e Shteti* \* *Politika e ideologjia* \* *Konflikte e integritet* \* *Etika dhe e drejta* \* *Ballkani dhe lindja e qytetërimeve perëndimore* \* *Rënia e qytetërimit europian në Ballkan* \* *Lindjet e modernizimit në Ballkan* \* *Proçese moderne integruese në Ballkan* \* *Varësia precaria e Shteteve ballkanike* \* *“Cortina di ferro” në Ballkan dhe efektet e saj*

Ese e artikuluar shumë mirë e shumë interesante. Autorja, e ardhur nga studimet filozofike, ka qënë pedagoge pranë Universitetit të Zagabria-s. Aktualisht pedagoge në Universitetin e Paris-it VII, pasi ka zgjedhur rrugën e mërgimit vullnetar në Francë. Teksti merr shkas nga ngjarje të dhimbshme personale të shkrimtares e cila ka jetuar krudalitetet e konfliktit në Jugosllavi. Jeta e saj personale është në kundërpozicion me stereotipet dhe paragjykimet sociale të brendshme dhe të jashtme në zonën ballkanike (sesi ata shikojnë e gjykojnë vetveten e sesi perëndimorët i shikojnë e gjykojnë ata). Përveç titullit, teksti është pak politik (pak i politizuar) dhe është i përqëndruar në një analizë filozofiko-sociale shumë akute, e shprehur me gjallëri gjuhësore e kapacitet tregues për ta bërë shkrimin më tërheqës si një roman i thjeshtë. Çeshtjet e trajtuara janë të shumta: gjuhësia, antropologjia, etnika, gjeo-politika. Rënimi i Ballkanit, vazhdon Iveković, është për t'u kërkuar në mbytjen e aventurës intelektuale të popujve të përfshirë në shqyrtim, në një "revolucion epistemologjik" që, fatkeqësisht, nuk është realizuar. I hidhur konstatimi në kuadrin e luftrave të zhvilluara në Ballkan në 15 vitet e fundit: «*Është për të besuar që dhuna, e pamenduar si pikë e verbër e mendimit, është tamam ajo që e nxit*».

Vendndodhja në Bibliotekë: BM 29I 30a



**\*Perëndimi dhe sfida ballkanike : qytetërimi, historia, politika /** Alessandro Perich. – Milano : Lupetti, c2004. - 282 fq. ; 23 cm.

TREGUESI. \* *Qytetërimi e progresi* \* *Shkenca e besimi fetar* \* *Shoqëria dhe ekonomia* \* *Kombi e Shteti* \* *Politika e ideologjia* \* *Konflikti e integrimi* \* *Etika dhe drejta* \* *Ballkani e lindja e qytetërimit perëndimor* \* *Rënia e qytetërimit european në Ballkan* \* *Lindjet e modernizimit në Ballkan* \* *Proçese moderne integruese në Ballkan* \* *Varësia precaria e Shteteve ballkanike* \* *"Cortina di ferro" në Ballkan dhe efektet*

Alessandro Perich, me origjinë nga Dalmazia, pedagog në Universitetin e Belgradit. Është ekspert i gjuhësisë së përgjithshme, historisë, metodologjisë dhe të shkencave sociale.

**Kërkimi historik i Ballkanit** është në origjinë të këtij shkrimi i cili lëviz nga vizioni (si dhe nga vetdija) që Ballkani i korespondon Greqisë Antike dhe është djepi i qytetërimit perëndimor. Fatkeqësisht gjatë shekujve, Ballkani ka humbur këtë rol.

Teksti paraqitet si pikë takimi i dy optikave: perëndimore e ballkanike. Dhe në fakt është i ndarë në dy pjesë: e para i është dedikuar Perëndimit duke konsideruar një qytetërim modern; e dyta Ballkanit i parë si një shoqëri në tranzicion.

Ballkani është sfida e re e Perëndimit, për t'u konkretizuar me kriteret e integritimit, bashkëpunimit dhe zgjerimit të tregjeve.

Vendndodhja në Bibliotekë: BM 29I 27a



**\*Rindërtimi i Kosovës dhe Ballkanit : shteti, shoqëria, trajnimi profesional e mass media /** S. Bartole ... [et al.] ; nën kujdesin e Francesco Russo. – Napoli : Edizioni Scientifiche Italiane, c2001. - 199 p. ; 24 cm.

TREGUESI. \* *Disa hyrje* \* *Modele të reja institucionale* \* *Shoqëria civile, Ojq-të, besimet fetare* \* *Mass media dhe trajnimi profesional*

Përmbledhje e ndërhyrjeve, në pjesën më të madhe, të Seminarit Ndërkombëtar "Ana tejtër e rikostruksionit" e mbajtur në 2001 në Trieste. Ky seminar shihte bashkëpunimin e ngushtë të institucioneve si Instituti

Ndërkombëtar *Jacques Maritain*, Universiteti i Trieste-s, Qendra e Dokumentimit Evropian të Departamentit të Shkencave Politike të Universitetit të Firenze-s dhe Departamentit të Shkencave Politike të Institutit Universitar Evropian të-s Fiesole. Të gjithë të bashkuar në OSDEE (Observatori rreth Demokracisë në Evropën Lindore).


Teksti rezulton i ndarë në katër pjesë. Pjesa e parë i dedikohet të dhënave të përgjithshme, e dyta kërkimit të **modeleve të reja institucionale**, e treta **shoqërisë civile**, **OJQ-ve**, besimeve fetare, e katërta mass-mediave e trajnimit profesional.

Aty ku shprehet besimi fetar, nënvijëzohet rëndësia e bashkëpunimit dhe kontributi i besimeve fetare në shoqërinë post-komuniste. Shteti post-komunist duhet t'i japë kishës (ose kishave) çdo mjet të nevojshëm për t'i garantuar besimit fetar një vend në jetën sociale.

Në përgjithësi, linja logjike e gati të gjitha ndërhyrjeve merr shkas nga qëndrimet e vendeve perëndimore në lidhje me luftën në Kosovë. Në fakt veprimi humanitar në Kosovë ka përfshirë gati të gjitha strukturat e fuqishme botërore. BE, marrëdhëniet e tij me NATO-n, marrëdhëniet lindore-perëndimore, vet roli i ONU janë vënë në diskutim.

Aleanca Atlantike ka nxjerrë në pah potencës së vet të jashtëzakonshme por është më e rëndësishme të mendohet procesi i integritimit politik e ushtarak në një Evropë të integruar e të zgjeruar.

*Vendndodhja në Bibliotekë: BM 29I 25a*



**\*Rethinking EU Integrations : albanian perceptions and realities / [a cura di] Albanian Institute for International Studies. – Tirana : Blendi Kajsiu, c2004. - 85 fq. : ill. ; 23 cm.**

I shkurtër por shumë interesant studimi i AIIS (Albanian Institute for International Studies) e i mundësuar falë financimeve të Ambasadës Anglese në Shqipëri.

Teksti përbëhet nga rezultati i një seri kërkimesh nëpërmjet pyetësorëve, të propozuar nga AIIS drejtuar përfaqësuesve të administratave publike, shoqatave tregëtare, OJQ-ve e mediave, për të pranuar nivelin e njohurive të tyre rreth BE. Përveç kësaj kërkohet të kuptohet edhe koncepti që këto grupe kanë për procesin e integritimit evropian. Një sondazh i 2002 ishte

shumë zhgënyes sepse rezultoi gati zero vetdija e Evropës së re dhe e modaliteteve të inserimit të Shqipërisë në Evropë. Të shumtë ishin dyshimet dhe moskuptimet. Edhe sondazhi i ri nuk është shumë pozitiv, sepse dëshmon një rezistencë shqiptare në procesin e integritimit. Duket se vetëm 7,5% të shqiptarëve beson se Shqipëria do të bashkohet me Europën në pesë vitet e ardhshme (në 2002 kjo shifër ishte 38,7%). Mendohet se koha e nevojshme mund të shkojë deri në 15 vjet e ndofta as pas këtyre viteve Shqipëria s'do të mund të arrijë standartet e kërkuara nga BE. Teksti përmban 58 grafikë, 8 tabela përshkruese, 1 pyetësor.

*Vendndodhja në Bibliotekë: BM 29H 32p*

[kthehu tek treguesi](#)



# TË PËRDITSHME

## **\*Cilat vlera në shoqërinë e shumë kulturave / Salman Rushdie**

Në: La \*Repubblica e datës 16/12/2005, fq.1

Artikulli ofron refleksione të shumta rreth modaliteteve të kuptimit të multikulturalitetit. Në qendër të debatit është Angli dhe ky centralizim, merr rezonancë nga atentatet e ndodhura në Londra më 7 Korrik, të planifikuar nga organizata terroriste islamike. Pozicione kontrastuese midis zërave që shohin multikulturalitetin si faktor destabilizues për identitetin kombëtar të vendit të përfaqësuar nga David Goodhart, drejtor i Prospect e nga krye peshkopi i parë me ngjyrë britanik John Sentamu. Akoma më i markuar pozicioni i qeverisë që nëvijëzon nevojën e kalimit të “provimit britanik”, për të patur nënshtetësinë. Favorues e mbështetës i multikulturalitetit si çelës interpretues i një shoqërie në të cilën “meticciano” shfaqet tashmë si element mbizotërues, është pozicioni i profesorit Parekh, autor i eseve të shumta rreth vlerës së multikulturalitetit dhe rreth interpretimit të multikulturalitetit në çelës introspektiv “...melange e kulturave është prezente në të gjithë ne, me kontraditat e tij”. Pluralizmi kulturor është rruga e vetme dhe më realiste për t’u ndjekur, monokultura “... një fantazi nostalgjike e parealizueshme...”. Por cilat janë vlerat e një shoqërie multikulturale? Sigurisht sensi i përkatësisë, asnjë shoqëri nuk mund të zhvillohet nëse qytetarët nuk njohin vlerat e nënshtetësisë së tyre, si rasti aktual i Francës.

*Vendndodhja në Bibliotekë: Seksioni DEM*

## **\*Liri e arsye : e vetmja pasaportë / Amartya Sen**

Në: \*Corriere della sera e datës 1/12/2005, fq. 8

Kriteri në bazë të dezertimit të multikulturalitetit, i trajtuar nga çmimi nobel për ekonominë Amartya Sen, është: garantimi i zgjedhjes së lirë kulturore ose tutelimi i identitetit të përcaktuar nga komuniteti besimtar i origjinës. Vlerat absolute të lirisë e të arsyetimit janë në tezën e çmimit nobel elementët thelbësor të multikulturalitetit që diferencohet nga “monokulturaliteti pluralist”. Britania e Madhe është vendi që prej kohësh ka nisur procesin e integritimit të personave me origjinë të ndryshme. Integritimi ka synuar mbi të gjitha tutelën dhe mbështetjen e lirisë së të gjithë residentëve legalë, imigrantë e vendas. E drejta e votës për të gjithë residentët britanikë të Commonwealth, që janë pjesa më e madhe e imigrimit jo europian, është në favor të integritimit. Stonimi i politikës britanike përfaqësohet nga promovimi aktiv i shkollave të reja besimtare për fëmijët myslymanë, sikh e kristianë.

Arsimimi duhet të zhvillojë kapacitetin e arsyetimit laik e të lirë rreth vendimeve të ardhshme.

*Vendndodhja në Bibliotekë: Seksioni DEM*

## **\*Puglia në Ballkan: Bari, një projekt për integritimin e zonës**

Në: La \*Gazzetta del Mezzogiorno e datës 21/10//2005, fq. 7

Shpallja e katërt për prezantimin e projekteve për programin e iniciativës komunitare i prosimitetit “Interreg III B - Cadses”. Programi përfshin nëntë vende të BE ndër të cilët edhe Italia, dhe nëntë shtete të tjera jo anëtare të BE të përcaktuar si subjekte të prosimitetit ose në pre aderim ndër të cilët Vendet Ballkanike e të Evropës Lindore. Roli i Cadses është nxitja dhe përfundimi më 31 Gusht 2008 i projekteve të iniciativës së përbashkët midis Shteteve për zhvillimin sostenibël të territorit. “Subjekte të prezantimit” të propozimeve janë entet lokale dhe administratat. Puglia, nënvijëzon asesori i Mesdheut Silvia Godelli, është kandidate për ndërhyrjet në transportet aeroportuale, në

promovim të kohezionit social e në një projekt pilot për zonat rurale. Partner i fuqishëm në programin Tele-spazio ku partner leader është Abruzzo për parashikimin e risqeve të mundshme.  
*Vendndodhja në Bibliotekë: Seksioni DEM*

**\*Edhe nëpërmjet librave bashkëpunim midis Italisë dhe Shqipërisë / Stefano Boccardi**

Në: La \*Gazzetta del Mezzogiorno e datës 25/11//2005, fq. 7

Dy ditë të dedikuara realizimit të projektit BiblioDocINN, promovim dhe zhvillim i modeleve inovative të bashkëpunimit midis bibliotekave dhe qendrave të dokumentimit italo-shqiptare. Delegacioni pugliez ka qënë i nderuar me pjesëmarrjen e Presidentit të Këshillit Rajonal të Puglias Pietro Pepe, e të Zëvendës Presidentit Luciano Mineo. Të dy kanë nënvijëzuar dëshirën e e Rajonit për të forcuar marrëdhëniet e miqësisë e të bashkëpunimit me Shqipërinë duke evidentuar se bibliotekat, në rastin specifik të projektit, janë konsideruar si inovacion dhe zhvillim i popujve. Presidenti dhe Zëvendës Presidenti janë shoqëruar nga Marilena Pinca (përgjegjëse e Sportelit Informativ të Rajonit të Puglias në Shqipëri) në vizitat e katër qyteteve: Tiranë, ku u zhvillua dita e parë e meeting ndërbibliotekar, Berat (qytet i UNESCO), Durrës (ku po përsosen disa projekte bashkëpunimi me Puglian, duke filluar nga sigurimi i portit), Shkodra, qyteti i dytë i meeting me praninë edhe të Konsullit Italian në Shkodër, pugliezi Roberto Orlando. Në të gjitha qytetet, delegacioni pugliez ka takuar autoritetet institucionale.

Projekti në konkluzion të vitit të dytë sjellë rezultatet e pozitive: botimi i buletinëve të parë tematikë dygjuhësh, instalimi i sporteleve informativi të BE, janë disa shembuj. Për impaktin pozitiv e vlerën kulturore projekti ka integruar në brendësi të tij Arkivin e Shtetit Shqiptar.

*Vendndodhja në Bibliotekë: Seksioni DEM*

[kthehu tek treguesi](#)